

From: Nesrin Lushta <Nesrin.Lushta@gjyqesori-rks.org>
Sent: Monday, June 28, 2021 1:20 PM
To: urbanizmi prishtine <urbaniz miprishtine@rks-gov.net>
Cc: Nesrin Lushta <Nesrin.Lushta@gjyqesori-rks.org>; Alltn Murseli <Alltn.Murseli@gjyqesori-rks.org>; lume.tahiri@gmail.com; lavdush-n@hotmail.com; esmazahiti@hotmail.com
Subject: Kundershtimi kerkes per ndertim nr.05-350/02-78983/21

Te nderuar,

Ne emër te gjithë banorëve të ndërtesës së banimit ne rr.Tringë Smajli nr.72 ne Prishtine e posaçërisht neve emrat e të cilëve janë më poshtë, në afatin ligjor ju dërgojmë:

KOMUNËS SË PRISHTINËS

Lënda: përgjigje / koment në njoftimin publik të datës 16.06.2021.

Më datën 16.06.2021. keni shpallur njoftimin publik duke na informuar se në Komunën e Prishtinës është dorëzuar **kërkesa nr.05-350/02-78983/21** e datës 05.05.2021. e pronarit Besnik Asllani, përmes së cilës kërkohet përcaktimi i kriterëve të caktuara për ndërtimin e ndërtesës banimore-afariste, me etazhitet 2B+P+5, në parcelat kadastrale nr.6528 dhe 6529 ZK Prishtinë, në kuadër të Planit Rregullues "Dodona" dhe PZHU.

Njëkohësisht jemi njoftuar se komentet tona mund t'i dorëzojmë deri më datën 01.07.2021.

Ne jemi banorët e ndërtesës banimore në rrugën Tringë Smajli nr.72, e cila gjendet në kufirin e ngastrave kadastrale të cekura më lartë.

Shprehim pakënaqësinë dhe mospajtimin e fuqishëm me këtë ndërtim dhe kërkojmë që parashtuesit të kërkesës të mos t'i lejohet ndërtimi.

Lokacioni në të cilin kërkohet ndërtimi është më së shumti 10 m larg ndërtesës ton. Këndi i ndërtesës ton është tërësisht i ngjitur me këtë lokacion, pra ka 0 m distancë. Dritaret dhe ballkonet tona janë të kthyera kah ky lokacion.

Nëse këtu ndërtohet një objekt me bodrum, katin përdhese dhe 5 kate, që është në lartësinë identike me ndërtesën ton, do të:

- mbyllet tërësisht pamja,
- rrezet e diellit nuk do depërtojnë aspak,
- rrezikohen themelet e ndertës ton,
- cenohet në tërësi jetesa normale dhe ambienti ekologjik.

Përveç kësaj, do të citojmë nenin 18.par.1. të Ligjit mbi Ndërtim nr.04/L-110, për përcaktimin e kushteve ndërtimore, sipas së cilit:

"Nëse nuk ekziston plani rregullativ urban, aplikuesi i propozon organit kompetent kushtet ndërtimore që dalin mbi bazën e diametrit prej pesëdhjetë (**50 metrave** nga vijat kufizuese të parcelës tokësore për të cilën aplikuesi ka kërkuar të ndërtoj objektin e tij ndërtimor."

Nga kjo dispozitë del se një ndërtim eventual i këtillë qenka në kundërshtim të plotë me ligjin.

Jemi të bindur se nuk do te lejoni një ndërtim kundërligjor i cili për ne do të ishte me pasoja të papërbalueshme të cilat më i lartë i cekëm.

Ju lutemi të konfirmoni pranimin e këtij kundërshtimi të dërguar me e-mail.

Ne do të përcjellim vendosjen e këtij kundërshtimi ne web faqen e Komunës, ashtu siç na informuat se do të veproni në bazë të nenit 13. të Udhëzimit administrativ

06/2017 për përcaktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje ndërtimi për kategorinë I dhe II.

Në Prishtinë,
Më 28.06.2021.

Me respekt,

Nesrin Lushta,
Lumnije Tahiri-
Bullatovci
Alltën Murseli,
Lavdie Mulolli,
Esmë Zahiti
Mihane Zogjani
Isa Lahi
Astrit Ukimeri